

Leje Kalimi

Përshkrimi

Pajisja me Leje Kalimi e shtetasve shqiptarë të rritur, që nuk kanë dokument të vlefshëm udhëtimi dhe që do të kthehen në Shqipëri.

Dokumentacioni i nevojshëm

- 1) Pasaportë e pavlefshme / kartë identiteti origjinale / certifikatë lindje nga gjendja civile përkatëse, e lëshuar jo më larg se 3 muajt e fundit nga data e kërkesës, e shoqëruar me kopjen e kartës së identitetit ose
- 2) Leje Drejtimi Automjeti, format i ri elektronik;
- 3) Denoncimi pranë autoriteteve kompetente vendase për humbjen e pasaportës, për rastet e humbjes;
- 4) 2 foto me përmasa 4x5 cm, dhe me sfond të bardhë;
- 5) Mandat pagesa me bankë.

Hapat e procedurës

- 1) Paraqitja personale;
- 2) Verifikimi i dokumentacionit nga konsulli;
- 3) Verifikimi i identitetit, nëse është e nevojshme;
- 4) Plotësimi i formularit LK 1.

Tarifa e shërbimit dhe afati

30 euro

Menjëherë ose në varësi të kohës së verifikimeve, kur janë të nevojshme.

Zyra

Të gjitha përfaqësitë diplomatike dhe konsullore

Shënime

Pagesa e tarifës së shërbimit konsullor kryhet nëpërmjet bankës. Afati i vlefshmërisë, sipas rrethanave 1 deri në 6 muaj.

Bëhet përjashtim i pranisë personale të personit kur shtetasi është i ndaluar, arrestuar ose burgosur. Në këtë rast lejohet pranimi i kërkesës së bërë nga autoritetet kompetente për të huajt në vendin pritës që merren me përbarimin e veprimeve të kthimit në atdhe të personave në gjendje të parregullt;

Përjashtim bëhet dhe për arsye të forta shëndetësore, kur personi nuk mund të paraqitet në përfaqësi. Në këtë rast kërkesën e bëjnë familjarët ose për këtë paraqesin deklaratë përfaqësimi dhe dokumente të tjera bindëse. Sipas mundësive, konsulli shkon dhe bën verifikimin në spital apo në vendin ku ndodhet i sëmuri.

Formularë të nevojshëm:

Formulari LK 1